



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:130562

Datë: 23.12.2022

Numri i dokumentit: 03820305

PS.nr.39/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari – kryetar i trupit gjykues, Valbona Musliu – dhe Valon Kurtaj – anëtar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Mirjetë Demiri – zyrtare ligjore pranë kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit H.S nga fshati Bresalc, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës², me numër PPS.nr.46/2017, të datës 07.10.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor **me datën 23.12.2022**, në prezencën e Prokurorit të shtetit nga PSRK – Afrim Shefkiu, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij avokatit Murat Demolli nga Prishtina, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.12.2022 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H S, nga i ati ..., e ëma, e gjinisë ..., i lindur me datën ... në Gjilan, tani me vendbanim në fshatin ..., i martuar, baba i .. fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal.. .

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

² Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, (Në tekstin e mëtejme PSRK)

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse fillimisht me datë 23.11.2015, me paramendim dhe me dashje si dhe me përgatitje paraprake së bashku me bashkëshorten e tij A.A dhe vajzën e mitur D.S, ka lëshuar territorin e Republikës së Kosovës, përmes Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, me numër fluturimi Zurich, WK 403, ka udhëtuar për në qytetin Stambollit të Republikës së Turqisë dhe përmes lidhjeve të caktuara ka depërtuar në Siri, me qëllim që t’i bashkëngjitet organizatës terroriste “ISIS”, e cila në këto vende ka qenë duke luftuar ku edhe është angazhuar si pjesëtarë i “ISIS-it”, si administrator në Byronë e ushtarëve të plagosur nën administrimin e “ISIS-it”, është financuar nga “ISIS” me shumën e të hollave prej nga 100 Dollar Amerikan në muaj, duke bashkëpunuar edhe me epror dhe luftëtarë të “ISIS-it”, si: L M, R A, B Sh, V Q, A M dhe N Le të tjerë e që nga B Sh ka pranuar një revole me rastin e kurorëzimit të vajzës së tij D.S me të njëjtin e që më pastaj është dorëzuar tek Forcat Demokratike Siriane, ku edhe me datë 28.05.2022 është riatdhesuar në Kosovës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 2, 4, 6, 7, 17 paragrafi 1, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 dhe 1.3, 83, 84 dhe 143 paragrafi 2 të KPRK-së, si dhe neneve 365, 367 dhe 453 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës³, të akuzuarin e;

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej katër (4) vite e tetë (8) muaj, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data: 01.08.2018 e tutje, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar në aktgjykim.

Ndaj të akuzuarit, vazhdohet paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me burgim.

³ Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejshëm KPP-së, nr.04/L-123, i datës 13.01.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.46/2017, të datës 07.10.2022, ndaj të akuzuarit H.S nga fshati Bresalc, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 paragrafi 2 të KPRK-së.

Pas ngritjes së aktakuzës në afatin ligjorë është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi fillestar, më datën 20.10.2022 në Departamentin e Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën seancë i akuzuari H S, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

Shqyrtimi i dytë, nuk është mbajtur për shkak se gjykata gjatë shqyrtimit fillestar kishte marr aktvendim me të cilin i kishte njoftuar të akuzuarin dhe mbrojtësin i tij se ata deri me datën 19.11.2022, duhet ti paraqesin me shkrim kundërshtimet ndaj provave konform nenit 249 të KPP-së dhe kërkesat për hedhjen e aktakuzës konform nenit 250 të KPP-së, ashtu që me datën 21.11.2022, brenda afatit gjyqësor mbrojtësi e të akuzuarit H.S Av.Murat Demolli, ka parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Ndërsa me datën 29.11.2022 Prokurori i shtetit nga PSRK Afrim Shefiku, parashtrorë përgjigje në kërkesën e mbrojtësit për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata, me datën 30.11.2022 ka marrë aktvendimin PS.nr.39/22, me të cilin ka refuzuar si të pabazuara kërkesën për hedhjen e aktakuzës të parashtruara nga mbrojtësi e të akuzuarit H.S Av.Murat Demolli. Kundër këtij aktvendimi palët nuk ka parashtruar ankesë.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimi gjyqësor⁴ më datën 23.12.2022, në të cilin kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit nga

⁴ Të gjitha procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 315 par.1 të KPP-së, janë përpiluar me shkrim të cilat procesverbale gjenden në shkresa e lëndës ashtu që shqyrtimi gjyqësor nuk është regjistruar me audio ose video incizim për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve në gjykatë në kohën kur janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor.

PSRK Afrim Shefiku, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av.Murat Demolli, ku dhe në të njëjtën ditë e ka shpallur aktgjykimin.

Prokurori i shtetit nga PSRK Afrim Shefiku, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor për veprën penale dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari H S, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë duke shtuar se jam penduar që kam shkuar në Siri, pra jam penduar prej kohës kur kam shkelë atje.

2. Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit i PSRK-së Afrim Shefiku, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetem në tërësi pranë aktakuzës së ngritur ndaj të akuzuarit H S, ngase i njëjti qysh në fillim të shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe se sa i përket gjendjes faktike, situata është plotësisht e qartë. Ndërkaq në rastin e marrjes së llojit dhe lartësisë së dënimit propozojë rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërkaq rrethanat renduese janë evidente dhe atë; pesha e veprës penale dhe rrezikshmëria shoqërore e të njëjtës. Konsideroj se koha e qëndrimit në zonat e konfliktit në Siri përkatësisht në kamp, nuk duhet të llogaritet si mbajtje e dënimit, ngase duke ju referuar nenit 80 të KPP-se, paraburgimi ose heqja e lirisë gjatë procedurës së transferimit të personit në një juridiksion tjetër dhe pjesa e dënimit të cilën e ka mbajtur kryesi sipas aktgjykimit të gjykatës së huaj, do të llogaritet në dënim të shqiptuar nga gjykata në Kosovë, për të njëjtën vepër dhe nëse dënimi i shqiptuar jashtë Kosovës nuk është i llojit të njëjtë, llogaritja do të bëhet sipas vlerësimit të gjykatës. Në rastin konkret nuk kemi kurrfarë vendimi apo aktgjykimi nga ana e organit ligj zbatues të vendit ku ka qenë i akuzuari, dhe po ashtu referuar nenit 39 par.3 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, llogaritja e paraburgimit i bëhet personave të ekstraduar përmes rrugëve diplomatike e që në rastin konkret kemi të bëjmë me riatdhesim nga zonat e konfliktit në Siri për në Kosovë. Sa për ilustrim kemi dy aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë: aktgjykimi PML.nr..., i datës 22.06.2022, ku është refuzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nga ana e mbrojtësit të dënuarit mu për këtë çështje, përkitazi me mos llogaritjen në paraburgim të kohës së qëndrimit

në Siri, dhe po ashtu kemi edhe aktgjykimin tjetër PML.nr. ... i datës 28.09.2022, ku është aprovuar kërkesa e prokurorit të shtetit me ç'rast është konstatuar shkelje e ligjit penal nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë në favor të dënuarit, mu për çështjen e llogaritjes së paraburgimit të të dënuarit në zonat e konfliktit në Siri, andaj propozojë që i njëjti të dënohet konform Kodit penal të Republikës së Kosovës.

Mbrojtësi i të akuzuarit H S, av.Murat Demolli, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari H S, kërkojë nga gjykata që të merr parasysh benefitet sa i përket sanksionit penal apo llogaritjes së dënimit. Njëherë kërkojë nga gjykata që të merr parasysh edhe qëndrimin e tij në kampet në Siri, së në kamp me qendru është me e vështirë se sa paraburgimi, d.m.th. në llogaritjen e dënimit ti llogariten edhe ai qëndrim. Sipas deklaratës së të akuzuarit, ky vetëm në kohën e fundit ka qëndruar mbi 4 vite dhe për kushte të mos flasim, ka pasur tortura të cilat dhe i njëjti ka qenë në gjendje jo të mire shëndetësore dhe ka qëndruar një kohë në spital pas riatdhesimit, dhe po ashtu edhe tani është jo mirë me shëndet dhe mendoj që shteti duhet të merret me qytetaret e vet kur i pranon për riatdhesim, duhet ti ketë në konsideratë, prandaj kërkojë që merren parasysh rrethanat të cilat janë më të lehta për të akuzuarin. Dhe nuk kemi çka me fol për provat, ngase me pranimin e fajësisë nuk mund të kundërshtohet, prandaj duke marrë për bazë gjendjen ekonomike të tij e ka të vështirë, është i pa punë, prandaj kërkojë nga gjykata që të njëjtit ti shqiptojë një dënim sa më të butë dhe të lirohet nga shpenzimet e procedurës.

I akuzuari H S, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: pajtohet me theksimet e mbrojtësit të tij dhe nuk kam çka të shtojë tjetër.

3. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit H.S për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokatin Murat Demolli, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e

prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

4. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë trupi gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari H S, me dashje ka kryer veprën penale: organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

5. Elementet e veprës penale

- Në nenin 143 të KPPK-së, në paragrafin 2 është parashikuar se: “*Kushdo që merr pjesë në veprimtarinë e grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.*”

6. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, trupi gjykues të akuzuarin H S, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojnë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese.

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin, nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet rënduese, por si rrethanë rënduese ka konsideruar:

- Rrezikshmëria - vlera e mbrojtur shoqërore, ku vepra penale e terrorizmit apo veprat penale të kësaj natyre janë vepra të një rrezikshmërie të lartë shoqërore, posaçërisht kur dihet se kjo vepër penale ka ndikim në sigurinë globale, respektivisht cenon sigurinë globale. I akuzuari me këtë aktgjykim është shpallur fajtor për vepër penale të integritit në organizatën terroriste e cila ka karakter të veprimit global dhe se ka marrë pjesë apo është rekrutuar për një kohë në një formacion luftarak jashtë vendit, që nënkupton se rrezikshmëria shoqërore dhe vlera e mbrojtur është e një serioziteti shumë më të madh;

- Motivi i kryerjes së veprës penale, motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë motivi religjioz - terrorist, ku i akuzuari me veprimet e veta ka tejkaluar - anashkaluar të gjitha interesat e përgjithshme shoqërore, kanë anashkaluar jetën dhe sigurinë e qytetareve, duke u integruar në struktura terroriste me qëllim të pjesëmarrjes në luftime. Pra, motivin e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, gjykata e konsideron si rrethanë rënduese, posaçërisht kur merret në konsideratë se i akuzuari e ka ditur fare mirë se në çfarë organizate - formacioni po integrohet dhe cila është veprimtaria e kësaj organizate.

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin, si rrethana lehtësuese i ka konsideruar:

- Gjendjen materiale, ku gjendja materiale e tanishme e të akuzuarit është nën mesataren familjare, ku i akuzuarit para kryerjes së veprës penale ishte i punësuar, mirëpo me rastin e arrestimit të tij është përkeqësuar është i gjendjes së dobët ekonomike si në aspektin e gjendjes së tij materiale e po ashtu edhe të familjes;

- I akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes, ku përpos që është mbajtës i vetëm i familjes së tij, në përbërjen familjare është bartës - përkujdeset materialisht edhe për bashkëshorten e tij të sëmur, pasi që të njëjta nuk mundë të përkujdeset për veten e saj për shkak të sëmundjes. Marrë në konsideratë, faktin se i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes, çdo sanksion penal në kohë më të gjatë do të rrezikonte ekzistencën dhe zhvillimin e tyre;

- Pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor për veprën penale për të cilën ngarkohet ku edhe i njëjti ka shpreh pendesë për veprime e tij të kryera.

- Sjellja e tij para kryerjes së veprës penale, i akuzuari para kryerjes së veprës penale nuk ka pasur ndonjë sjellje kriminale, ku gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar se i njëjti më herët nuk ka kryer ndonjë vepër penale apo të ketë qenë i dënuar, por kjo është hera e parë ku i njëjti ka rënë në kundërshtim me ligjin, në fakt ai ka qenë duke u hetuar për një rast tjetër penal e nga i cili rast ka rrjedhë edhe kjo vepër penale, që nënkupton ky rast penal i cili është vendosur me këtë aktgjykim dhe rasti për të cilin i akuzuari vetëm se është dënuar, janë çështje e ndërlidhur hetimore nga e cila kanë rezultuar këto dy raste. I akuzuari para se të bie në kontakt me persona të cilët e kanë motivuar për të shkuar në Siri, nuk ka pasur ndonjë historik kriminal, por ka punuar në profesionin e tij me biznesin e tij individual për të siguruar bazën financiare për vete dhe familjen.

Prandaj, duke marrë për bazë të gjitha këto gjykata ardhur në përfundim se në rastin duhet aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit nga nenin 75 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, prandaj edhe ka shqiptuar dënim nën kufijtë që parasheh neni 76 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, ngase ka vlerësuar se edhe me dënimin burgim të shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, dhe se ky dënim si i tillë i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8.Vendimi për llogaritjen e paraburgimit

Gjykata, konform nenit 83 dhe 84 të KPRK-së, ka marr vendim që të akuzuarit t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim sipas vendimeve të kësaj gjykate si dhe koha e heqjes së lirisë gjersa ishte arrestuar nga Forcat Demokratike Siriane si anëtar i "ISIS" që vërtetohet nga dokumentacioni i Departamentit Amerikan të Drejtësisë – Byrosë Federale të Hetimeve, përkatësisht shkresave me numër KS-18-113 e datës 14.09.2018, në të cilat konstatohet se i njëjti ishte nën kujdestarinë e Forcave Demokratike Siriane nga fundi i gushtit 2018, ashtu që si datë gjykata e ka marrë datën 01.08.2018, për tu llogaritur si kohë e kaluar në paraburgim. Vendimin

për llogaritjen e heqjes të lirisë si kohë e kaluar në paraburgim gjykata e ka marrë duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore, përkatësisht vendimeve⁵ të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

9. Vendimi për lirim nga shpenzimet e procedurës penale

Gjykata, duke e pasur gjendjen e dobët ekonomike të akuzuarit dhe duke u bazuar në nenet 453 par.4 të KPP-së, ka vendosur që i akuzuari të lirohet nga shpenzimet e procedurës penale nga neni 450, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. deri në 2.6. të KPP-së, ngase me pagesën e tyre do të rrezikohej gjendja materiale të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht për shkak se është i pa punë dhe i gjendjes së dobët ekonomike.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- DEPARTAMENTI SPECIAL -

PS.nr.39/22, me datë 23.12.2022

Zyrtarja ligjore,

Mirjetë Demiri

Kryetari i trupit gjykues,

Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

⁵ Shiqo Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special, numër APS.nr.8/22 të datës 13.04.2022 dhe APS.nr.45/22, të datës 08.12.2022.